

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbyllet me sukses edicioni i tretë i “Serenights Festival”/ Katër netë nën tingujt e serenatave
ADRESA	https://www.cna.al/qyteti-im/mbyllet-me-sukses-edicioni-i-trete-i-serenights-festival-kater-nete-ne-i474739
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 20:54:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 20:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2088dc56a6d0ffc80969ae0c5a6d66417a6682904ff1cb16f93cfac201fd98a0
TEKSTI	2a36c887dcc4d41af52146663b9a20bdf0edb561b0205ba9a304ca2b3db88c37
PAMJA	e463b237cbfd2aeddee27e9baa787c16b568013a7e5a2de6a5b9c0d7916c878b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86bc6e444e92bec7aa58b4919584d4ac949e6f66b018772dca7a3e55840c9924
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c84bdf310a7d2da332ce9ad73dbfc395c2c61077bcda21e431ca7692af89529f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86bc6e444e92bec7aa58b4919584d4ac949e6f66b018772dca7a3e55840c9924>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

22:40 Qyteti im

Korça i ka dhënë fund edicionit të tretë të Serenights Fes...

Mbyllet me sukses edicioni i tretë i “Serenights Festival”/ Katër netë nën tingujt e serenatave



20 Shtator 2026, 22:40, Qyteti im CNA



Korça i ka dhënë fund edicionit të tretë të Serenights Festival, një aktivitet që për katër netë me radhë solli në hapësirat karakteristike të qytetit muzikën, traditën dhe emocionet e serenatave korçare. Nata përmbyllëse u zhvillua në Rrugicën e Mitropolisë, aty ku tingujt e muzikës dhe interpretimet e artistëve rikthyen atmosferën e serenatave nën ballkone e dritare, duke i dhënë jetë një prej traditave më të njohura të qytetit.





Zgjedhja e Rugicës së Mitropolisë nuk ishte e rastësishme. Ambientet karakteristike, ballkonet dhe dritaret e vjetra krijuan sfondin e përshtatshëm për këngët që flasin për dashurinë, mallin dhe marrëdhëniet njerëzore.



Drejtuksi artistik, Josif Minga, thotë se përmes kësaj mbrëmjeje synuan të rikthenin gjallërinë e serenatave në hapësirat ku ato kanë lindur dhe kanë jetuar ndër vite.

“Ne jemi pak a shumë grupi me përbërje pak më profesionale, sepse janë të gjithë muzikantë të kualifikuar, si nga zërat, ashtu edhe nga instrumentet. Menduan që ta përmbyllim këtë event në ato lloj ambientesh të cilat i shkojnë këngës korçare, serenatës. Duke qenë poshtë ballkoneve, nën dritaret e fshehura, shfaqen të gjitha ato brenga të heshtura që kanë jetuar prej kohësh. Pavarësisht se ishin të përgjumura, ka ardhur rasti që t’i gjallërojmë nëpër rrugicat dhe ambientet e qytetit. Çdo gjë ka elementin e natyrshëm. Megjithatë ka hequr ato sikletet e mëparshme, përsëri tregon mbijetesën, një mbijetesë më shumë shpirtërore, të përfaqësimit të anës shpirtërore të marrëdhënieve të këtij qyteti dhe më gjerë. Kjo është surpriza e sotme”, tha Minga.





Josif Minga

Serenata korçare mbetet një pjesë e rëndësishme e identitetit të qytetit, por edhe një traditë që kërkon të përcillet te brezat e rinj. Për Josif Mingën, interesi i të rinjve për këtë muzikë është një shenjë se serenata vazhdon të ketë vend në jetën kulturore, edhe përballë ndikimeve të shumta muzikore të kohës. Ai thekson se njohja me kulturat e tjera nuk duhet të përjashtojë traditën vendase, e cila mbetet pjesë e formimit dhe identitetit të çdo brezi.

“Përkundrejt gjithë invazionit kulturor që ndodh në përgjithësi, kam vënë re që ka shumë grupe të rinjsh që janë të interesuar, sepse kjo është një mëvetësi origjinale që mbase nuk shkëmbehet. Secili pajiset me një multikulturë dhe, në të njëjtën kohë, pajiset edhe me kulturë tradicionale, e cila i shërben. Sepse, në fund të fundit, në një gëzim të caktuar nuk mund të këndojë as ‘O Sole Mio’, as ‘Mamma Mia’, por do të këndojë pikërisht ato këngë të cilat kanë përkundur prindërit e tyre e gjithçka”, shtoi ai.


Për serenatisten Jorgjeta Lalazi, nata përmbylëse ishte e mbushur me emocione, por edhe një mundësi për t’iu drejtuar të rinjve që po përpunonin të ruajnë dhe të interpretojnë këtë traditë. Ajo vlerëson përpjekjet e brezit të ri për ta çuar përpara serenatën, ndërsa thekson rëndësinë e ruajtjes së origjinalitetit të saj. Sipas Lalazit, serenata duhet të këndohet duke respektuar mënyrën se si është krijuar dhe përcjellë ndër vite, pa penguar njëkohësisht zhvillimin dhe përfshirjen e artistëve të rinj.



Jorgjeta Lalazi

“Emocione shumë të forta. Dua të bëj më të mirën që t’i them rinisë: kështu këndohet serenata e vërtetë. Besoj se po mundohen, mundohen. Por unë u lë një amanet: të këndohet, jo kështu siç e këndoj unë, por kush është më e mira, siç e ka bërë i vërteti. Origjinaliteti duhet, por rinia ecën përpara, kështu që ne nuk ia prishim. Më ka pëlqyer, të them të drejtën. Mundohet rinia të bëjë më të mirën. Gëzohem që ecin përpara. Këtë kam qejf”, tha Lalazi.

Për këngëtareshen Gloria Nure, kjo natë kishte një domethënie të veçantë, pasi solli në vëmendje serenata që kanë lënë gjurmë në historinë e qytetit. Të interpretuara dhe të përpunuara artistikisht nga drejtuesi muzikor Josif Minga, këto këngë rikthyen në skenë histori dhe emocione që vazhdojnë të jenë pjesë e kujtesës kolektive të korçarëve. Nure e konsideron serenatën një nga elementet thelbësore të identitetit të qytetit dhe thekson përgjegjësinë që kanë artistët për ta ruajtur atë në formën e saj origjinale, duke mos e zëvendësuar me tendencat moderne.





Gloria Nure

“Ndryshe nga netët e tjera, kjo natë është pak më e ndjeshme, sepse na rikthen në kohë. Ka ato serenata të cilat kanë bërë historinë në qytetin tonë. Janë ato serenata që janë kthyer në histori të bukura të qytetit dhe ne, për fat të mirë, i interpretojmë sot, të risjella dhe të përpunuara me shumë mjeshtëri nga profesori ynë i dashur, Josifi. Është një nga pjesët më thelbësore të identitetit tonë si korçarë dhe ne, me shumë kënaqësi, por edhe me shumë përgjegjësi, përpiqemi që ta çojmë përpara, duke e ruajtur formën e saj ‘bio’ dhe atë natyrale, pa e ndryshuar me modernitetin e kohës. Sepse, në qoftë se ndryshojmë këtë pjesë të qytetit tonë, të historisë sonë, të identitetit tonë, të trashëgimisë sonë kulturore, çfarë do të mbetet Korça pa serenatën?”, u shpreh Nure.


Përgjatë katër netëve, Serenights Festivali solli një program të larmishëm artistik, duke ndërthurur muzikën me hapësirat karakteristike të Korçës. Organizatorët synuan që serenata të mos mbetet vetëm një kujtim i së kaluarës, por të përjetohej si një ndjenjë e gjallë, që bashkon artistët dhe publikun. Organizatorja Blerta Belliu shprehet se ky edicioni solli shumë artistë, instrumentistë dhe këngëtarë, ndërsa thekson se qëllimi ishte krijimi i katër netëve të paharrueshme për qytetin dhe për të gjithë ata që e duan serenatën.




Blerta Belliu

“Atëherë, sot jemi në natën e fundit të Serenights, Festivalit të Netëve të Serenatës. Shumë artistë, shumë instrumentistë, këngëtarë, miq të Korçës, siç shihet edhe pas meje. Serenata ka ardhur në shumë forma, sepse dihet që serenata nuk është këngë, por është ndjenjë. Dhe ne jemi munduar që të jenë katër netë të paharrueshme. Shpresoj që publiku korçar e ka shijuar dhe kemi mundur t’ju përcjellim atë që ju keni dashur”, u shpreh ajo.

Me tingujt e serenatave, interpretimet e artistëve dhe pjesëmarrjen e publikut, mbyllet me sukses edicioni i tretë i Serenights Festivali në Korçë. Katër netët e festivalit sollën muzikë, emocione dhe traditë në disa prej hapësirave karakteristike të qytetit, duke rikthyer serenatën në rrugicat dhe nën ballkonet korçare. /CNA





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.